



Sistemi tatimor në Kosovë

Kosova ka zhvilluar një sistem fiskal të bazuar në përvojat dhe politikat më të mira të Bashkimit Evropian, në mënyrë që të ketë politika fiskale dhe legjislacion sa më të përafërt me atë të BE-së. Kjo vlen për tatimet dhe politikat doganore duke përfshirë tatimet direkte dhe indirekte (Tatimi në të Ardhurat e Korporatave, Tatimi në të Ardhurat Personale, Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, Dogana, Akciza, etj).

Sistemi tatimor në Kosovë përbën një pako ligjesh tatimore dhe udhëzimesh administrative.

Ky dokument përmban informacion rreth:

- Tatimit në të Ardhurat e Korporatave (TAK);
- Tatimit në të Ardhurat Personale (TAP);
- Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH);
- Detyrimeve Doganore;
- Akcizës;
- Dispozitat e Veçanta;
- Transferimi i Çmimeve;
- Shmangies së tatimit të dyfishtë.

Dokumenti bazohet në ligjet relevante në fuqi të cilat zbatohen nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës.

I. TATIMI NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE (TAK)

Tatimi në të Ardhurat e Korporatave aplikohet në të ardhurat e tatueshme të korporatave. Tatimpaguesit me të ardhura bruto vjetore prej 30,000 € apo më pak, taten në masën 3% (për veprimtaritë siç është tregtia, transporti, bujqësia dhe veprimtaritë e ngjashme komerciale) apo 9% (për veprimtaritë shërbyese, profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme).

Tatimpaguesit me të ardhura bruto vjetore mbi 30,000€ taten me 10% në të ardhurat e tatueshme.

• Të ardhura të tatueshme

Të ardhurat e tatueshme për një periudhë të tatueshme është ndryshimi ndërmjet të ardhurave bruto të pranuar ose të krijuara gjatë periudhës tatimore dhe zbritjeve të lejueshme.

- Për Tatimin në të Ardhura të Korporatave, **periudhë tatimore** është viti kalendarik.
- **Tatimpagues** sipas Ligjit për Tatim në të Ardhura të Korporatave, janë:
 - Korporata apo ndonjë ndërmarrje tjetër afariste që ka statusin e personit juridik sipas ligjit në fuqi në Kosovë,
 - Shoqëria tregtare që vepron me pasuri në pronësi shoqërore ose publike,
 - Organizata e regjistruar si organizatë jo-qeveritare;
 - Personi jo rezident me njësi të përhershme në Kosovë.

• Objekti i tatimit

Objekt i tatimit për tatimpaguesin rezident janë të ardhurat e tatueshme me burim në Kosovë dhe jashtë Kosovës.

Objekt i tatimit për tatimpaguesin jo rezident janë të ardhurat e tatueshme me burim në Kosovë.

• Norma tatimore

Tatimi në të Ardhura të Korporatave është dhjetë për qind (10%) e të ardhurave të tatueshme.

• Të ardhurat e liruar

Të ardhurat në vijim janë të lira nga Tatimi në të Ardhurat e Korporatave:

- Të ardhurat e OJQ-ve që kanë fituar dhe mbajtur statusin e përfituesit publik, me kusht që të ardhurat të shfrytëzohen vetëm për qëllime të përfitimit publik;
- Të ardhurat e Bankës Qendrore të Kosovës dhe të institucioneve financiare qeveritare ndërkombëtare të lejuara dhe të autorizuara për të vepruar në Kosovë;
- Interesi nga instrumentet financiare i lëshuar apo garantuar nga Autoriteti Publik i Kosovës;
- Të ardhurat e Bashkësive fetare sipas Ligjit për Lirinë Fetare në Kosovë për ushtrimin e aktivitetit ekonomik të veçantë për vet mbështetjen e tyre;
- Të ardhurat e kontraktorëve primar ose nënkontraktorëve, përveç personave vendor, që janë krijuar nga kontratat për

- furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të Kombeve të Bashkuara, agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara, KFOR-it dhe Agjencinë Ndërkombëtare për Energji Bërthamore.
- Të ardhurat e kontraktorëve primar ose nënkontraktorëve, përveç personave vendor, që janë krijuar nga kontratat me qeveritë e huaja, organet e tyre dhe Agjencitë, Bashkimin Evropian, Agjencitë e Specializuara të Bashkimit Evropian, Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve në mbështetje të projekteve dhe programeve për Kosovën.
- Të ardhurat e përfituara nga grantet, subvencionet dhe donacionet, në harmomi me rregullat dhe kushtet e përfitimit.
- Dividenda e paguar apo pranuar për personin rezident dhe jo-rezident.

• Humbja tatimore

Shuma e humbjes tatimore mund të bartet deri në katër (4) vite të njëpasnjëshme tatimore dhe është e disponueshme si zbritje ndaj çfarëdo të ardhure për ato vite.

Nëse biznesi ka ndryshim në pronësi prej më shumë se pesëdhjetë për qind (50%) apo nëse një ndërmarrje personale afariste është ndryshuar në ndonjë formë tjetër biznesi (entitet juridik, ortakëri apo të ngjashme.) bartja e humbjes nuk do të lejohet.

• Shpenzimet e përfaqësimit

Shpenzimet e përfaqësimit do të jenë të kufizuar në një për qind (1%) të të ardhurave bruto vjetore.

• Zhvlerësimi

E gjithë prona e prekshme e tatimpaguesit që i nënshtrohet zhvlerësimit caktohet në një rën prej kategorive vijuese:

- **Kategoria 1 - Norma e zhvlerësimit 5%**, ku bëjnë pjesë: ndërtesat dhe strukturat tjera ndërtimore.
- **Kategoria 2 - Norma e zhvlerësimit 20%**, ku bëjnë pjesë: automobilat dhe kamionët e lehtë, mjetet e rënda për transport, pajisjet për bartje të dheut, buldozerët, gërmuesit e dheut dhe mjetet tjera të rënda, kompjuterët, pjesët shtesë për kompjuterë dhe pajisjet tjera për përpunimin e të dhënave, mobilet dhe pajisjet për zyra, instrumentet, gjërat e ndryshme dhe pajisjet tjera shtesë, dhe bagëtitë e shfrytëzuara për prodhim ose për mbarështim;
- **Kategoria 3 - Norma e zhvlerësimit 10%**, ku bëjnë pjesë: uzinat dhe makineria; inventari i hekurudhës dhe

- lokomotivat që shfrytëzohen për transportin hekurudhor; aeroplanët; anijet dhe bimët shumë vjeçare dhe shkurret e shfrytëzuara për vreshtari ose për prodhimin e frutave si p.sh. mollët, dardhat, arrat, boronicat dhe të tjera; dhe të gjitha asetet e prekshme që nuk janë përfshirë në Kategorinë 1 apo Kategorinë 2.

• Amortizimi

Shpenzimet për mjetet e paprekshme, të cilat kanë afat të kufizuar përdorimi, përfshirë patentet, të drejtat e autorit, licencat për vizatime apo modele, kontratat dhe të drejtat ekskluzive, zbriten në formë të detyrimeve të amortizimit sipas metodës lineare dhe lejimi bazohet në afatin e përdorimit të pasurisë të përcaktuar në marrëveshjen ligjore mbi përvetësimin dhe përdorimin e pasurisë së paprekshme.

• Zbritjet e posaçme për pasuritë e reja

Lejohet zbritje e veçantë prej dhjetë për qind (10%) të çmimit të përvetësimit të pasurisë në vitin në të cilin pasuria është vënë për herë të parë në shërbim.

Zbritja prej dhjetë për qind (10%), bëhet përveç zbritjes normale të zhvlerësimit të lejueshëm.

Zbritja lejohet vetëm nëse pasuria është e re ose është vënë për herë të parë në përdorim në Kosovë. Zbritja nuk lejohet nëse pasuria është bartur nga një biznes ekzistues ose një biznes i mëparshëm në Kosovë.

• Tatimi i mbajtur në burim në paga, pensione, interes, të drejtat pronësore dhe qira

Punëdhënësi i cili është punëdhënësi kryesor i të punësuarit, mban në burim një shumë të tatimit për periudhën përkatëse të pagesave të pagave, në përputhje me normat e përcaktuara në nenin 6 të Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale.

Punëdhënësi i cili nuk është punëdhënësi kryesor i të punësuarit, mbanë në burim shumën prej dhjetë për qind (10%) të pagave të tatueshme për periudhën tatimore.

Pensionet e paguara nga, apo për interes të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës apo nga një fond i autorizuar plotësues i pensioneve i rregulluar me legjislacionin mbi kontributet pensionale, si dhe sigurimet shëndetësore sipas Ligjit për Sigurimin Shëndetësor, i nënshtrohet mbajtjes së tatimit në burim nga paguesi i pensioneve apo i sigurimeve shëndetësore të tilla në shkallët e parapara në legjislacionin përkatës për Tatimin në të Ardhurat Personale;

Tatimpaguesi që paguan interes për kreditë e marra duke përfshirë huazimet apo të drejtat pronësore, personave rezidentë dhe jo rezidentë, mban tatimin në burim në shkallën dhjetë për qind (10%) në kohën e pagesës apo kreditimit në llogarinë e përfituesit dhe transferon tatimin e mbajtur në burim në llogarinë e përcaktuar nga ATK, në një bankë ose institucion financiar të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

Tatimpaguesi që paguan qira mban tatimin në burim nëntë për qind (9%) në kohën e pagesës apo të kreditimit dhe transferon tatimin e mbajtur në burim në llogarinë e përcaktuar nga ATK, në një bankë ose institucion financiar të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

• Mbajtja e tatimit në burim për kategori të veçanta

Tatimpaguesi që bënë pagesa për personat fizik jo-afarist, bujqit, fermerët, grumbulluesit e materialeve ricikluese, frutave të malit, bimëve mjekuese dhe të ngjashme me to, në momentin e pagesës mban tatimin në burim në shkallën prej tre për qind (1%) në bruto pagesë.

• Mbajtja në burim në pagesa të caktuara për jo-rezidentët

Të ardhurat që i atribuohen një jo-rezidenti për shërbimet e ofruara fizikisht në Kosovë, si një zbatimës, sikurse është teatri, figurat e lëvizshme, artistë, këngëtar apo muzikant, ose si një sportist, nga aktivitetet e tij apo saj, i nënshtrohen mbajtjes së tatimit në burim nga paguesi i të ardhurave, qoftë të paguara drejtpërdrejtë apo tërthorazi personit jo rezident. Po ashtu të ardhurat e realizuara nga marrëveshjet apo kontratat, qofshin me shkrim apo me gojë, me personat apo entitetet e Kosovës, nga një person apo entitet jo-rezident, për shërbimet e kryera fizikisht në Kosovë, i nënshtrohen mbajtjes së tatimit në burim nga paguesi i të ardhurave, përderisa personi apo entiteti jorezident nuk ka njësi të përhershme në Kosovë.

Shuma e mbajtjes së tatimit në burim është pesë për qind (5%) e kompensimit bruto.

• Trajtimi i aktiviteteve të sigurimit

Kompanitë e sigurimit (që bëjnë sigurimin ose ri-sigurimin e jetës, pronës, rreziqeve tjera) nga 5 Gushti 2019 deklarojnë dhe paguajnë tatimin bazuar në të ardhurat reale.

• Kërkesa për libra dhe regjistrime

Tatimpaguesi me të ardhura vjetore bruto prej pesëdhjetëmijë euro (30,000€) ose më tepër dhe ata me të ardhura vjetore bruto më të ulëta se pesëdhjetëmijë euro (30,000€) të cilët zgjedhin të taten në bazë të të ardhurave reale, mban librat dhe regjistrimet në pajtueshmëri me kërkesat e përcaktuara në nenin 35 të Ligjit për Tatim në të Ardhura të Korporatave dhe Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Pra, tatimpaguesi i tillë mban libra dhe regjistrime në përputhje me Standardet Kosovare të Kontabilitetit.

Tatimpaguesi me të ardhura vjetore bruto deri në pesëdhjetëmijë euro (30,000€) të cilët nuk kanë zgjedhur të taten në bazë të të ardhurave reale, mban librat dhe

regjistrimet në pajtueshmëri me kërkesat e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit për Tatim në të Ardhura të Korporatave dhe Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

• Deklarata e tatimit

Tatimpaguesi, nga i cili kërkohet apo ai i cili zgjedh t'i nënshtrohet tatuarjes në bazë të të ardhurave reale, është i obliguar të përgatis dhe deklaroj të ardhurat, duke përshtatur për qëllime tatimore, të ardhurat dhe shpenzimet e raportuara.

• Pagesat e tatimit

Tatimpaguesi me të ardhura bruto vjetore deri në pesëdhjetëmijë euro (30,000€) i cili nuk kërkohet ose nuk ka zgjedhur për tatuarje në baza reale, bënë pagesat për tremujor, si në vijim:

- Tre për qind (3%) të të ardhurave bruto të pranuar nga tregtia, transporti, bujqësia dhe veprimtaritë e ngjashme komerciale të çdo tremujori, por jo më pak se 37.5€ për tremujor;
- Nëntë për qind (9%) të të ardhurave bruto të pranuar, nga shërbimet, veprimtaritë profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme të çdo tremujori, por jo më pak se 37.5€ për tremujor;
- Dhjetë për qind (10%) të të ardhurave të tatueshme të qirasë për tremujor (të ardhurat bruto të qirasë të zvogëluara me zbritjet e lejueshme sipas nenit 9, paragrafit 4 të Ligjit për TAK), të zvogëluara nga çdo shumë e tatimit të mbajtur në burim gjatë atij tremujori në pajtim me nenin 30, paragrafin 3 të Ligjit për TAK;

Tatimpaguesi i cili nuk ka të ardhura në një periudhë tremujore, nuk kërkohet pagesë, por tatimpaguesi është i obliguar të dorëzojë formularin me obligim pagese zero.

Tatimpaguesit me të ardhura vjetore bruto mbi pesëdhjetëmijë euro (30,000€) dhe ata që zgjedhin vullnetarisht të taten në bazë të të ardhurave reale, janë të obliguar të bëjnë pagesa paradhënie tremujore për Tatimin në të Ardhura të Korporatave, si në vijim:

- Një të katërtën (1/4) e detyrimit të përgjithshëm tatimor për periudhën tatimore në vijim, bazuar në të ardhurën e tatueshme të vlerësuar dhe të zvogëluar nga cilado shumë e mbajtur në burim gjatë tremujorit që lidhen me ato të ardhura, në përputhje me legjislacionin përkatës për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, apo
- Për periudhën e dytë dhe periudhat vijuese tatimore për të cilat tatimpaguesi bënë pagesën sipas këtij paragrafi, së paku një të katërtën (1/4) e njëqinddhjetë për qind (110%) të detyrimit të përgjithshëm tatimor të periudhës paraprake për periudhën aktuale të zvogëluar nga cilado shumë e mbajtur në burim gjatë tremujorit që lidhen me

- ato të ardhura, në përputhje me legjislacionin përkatës për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.

Tatimpaguesi i cili bënë pagesën tremujore paradhënie, obligohet të bëjë një deklaratë vjetore me rregullime përfundimtare të tatimeve dhe paguan shumën e duhur deri më 31 mars të vitit pas periudhës tatimore.

II. TATIMI NË TË ARDHURA PERSONALE (TAP)

Tatimi në të Ardhura Personale aplikohet në të gjitha të ardhurat që pranon një individ e që janë të tatueshme në bazë të Ligjit për Tatimin në të Ardhura Personale.

- **Tatimpagues** sipas Ligjit për Tatim në të Ardhura Personale, janë: personat fizik rezident dhe jo rezident, ndërmarrja personale afariste, ortakëritë dhe shoqëritë, të cilët pranojnë ose krijojnë të ardhura bruto nga çfarëdo burimi, duke përfshirë pagën, veprimtarinë afariste, qiranë, fitoren në lotari, interesat, fitimet kapitale, shfrytëzimin e pasurisë së paprekshme, pensionet, si dhe çdo të ardhur tjetër që rrit vlerën neto të tatimpaguesit.
- Për Tatimin në të Ardhura Personale, **periudhë tatimore** është viti kalendarik.

• Objekti i tatimit

Objekt i tatimit për tatimpaguesin rezident janë të ardhurat e tatueshme me burim në Kosovë dhe jashtë Kosovës.

Objekt i tatimit për tatimpaguesin jo rezident janë të ardhurat e tatueshme me burim në Kosovë.

• Të ardhurat bruto

Me përjashtim të të ardhurave që lirohen nga tatimi sipas ligjit, të ardhurat bruto nënkuptojnë të gjitha të ardhurat e fituara ose të akumuluar nga çfarëdo burimi, duke përfshirë: pagën, qiranë, aktivitetin afarist, përdorimin e pasurisë së paprekshme, interesin, fitimet kapitale, lotaritë dhe lojërat tjera të fatit, pensionet e paguara nga një punëdhënës i përparshëm, apo në përputhje me Ligjin për pensionet në Kosovë dhe çdo e ardhur tjetër që rrit vlerën neto të tatimpaguesit.

- **Të ardhura të tatueshme** për një periudhë tatimore nënkupton ndryshimin në mes të të ardhurave bruto të pranuar apo të rrjedhura/akruara gjatë një periudhe tatimore dhe zbritjeve/lejimeve të lejueshme në lidhje me të ardhurat bruto të tilla.

Normat e tatimit

Tatimi në të Ardhura Personale aplikohet sipas shkallëve në vijim:

Norma tatimore	Të ardhurat mujore	Të ardhurat vjetore
0%	0 deri 80	0 deri 960
4%	80 deri 250	960 deri 3000
8%	250 deri 450	3000 deri 5400
10%	450 e tutje	5400 e tutje

Tatimpaguesit me të ardhura bruto vjetore prej 50,000€ apo më pak, taten në masën 3% (për veprimtaritë siç është tregtia, transporti, bujqësia dhe veprimtaritë e ngjashme komerciale) apo 9% (për veprimtaritë shërbyese, profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme).

Tatimpaguesit me të ardhura bruto vjetore mbi 50,000€ dhe ata të cilët kanë përzgjedhur vullnetarisht të taten në të ardhura reale, taten sipas shkallëve në vijim:

- Për të ardhurat e tatueshme nëntëqind e gjashtëdhjetë euro (960 €) ose më pak, zero për qind (0%);
- Për të ardhurat e tatueshme mbi nëntëqind e gjashtëdhjetë euro (960 €) deri në tremijë euro (3.000 €), duke përfshirë edhe shumën tremijë euro (3.000 €), katër për qind (4%) të shumës mbi nëntëqind e gjashtëdhjetë euro (960 €);
- Për të ardhurat e tatueshme mbi tremijë euro (3.000 €), deri në pesëmijë e katërqind (5.400 €), duke përfshirë edhe shumën pesëmijë e katërqind (5.400 €), Tetëdhjetë e një pikë gjashtë euro (81.6 €) plus tetë për qind (8%) të shumës mbi tremijë euro (3.000 €); dhe
- Për të ardhurat e tatueshme mbi pesëmijë e katërqind (5,400 €), dyqind e shtatëdhjetë e tre pikë gjashtë euro (273.6 €) plus dhjetë për qind (10%) të shumës mbi pesëmijë e katërqind (5,400 €).

• Të ardhurat e përjashtuara

Nga Tatimi në të Ardhura Personale përjashtohen të ardhurat si në vijim:

- Rrogat e përfaqësuesve të huaj diplomatik e konsullor dhe personeli i jashtëm i Ambasadave apo Zyrave të Ndërlidhjes së shteteve të huaja në Kosovë;
- Rrogat e përfaqësuesve dhe zyrtarëve të jashtëm si dhe punonjësve të jashtëm të organizatave ndërkombëtare qeveritare dhe organizatave joqeveritare ndërkombëtare;
- Rrogat e përfaqësuesve dhe zyrtarëve të jashtëm si dhe punonjësve të jashtëm të agjencive donatore, të

- kontraktorëve të tyre apo të fondacioneve që realizojnë ndihmën humanitare, punën e rindërtimit, administratën civile apo ndihmën teknike në Kosovë;
- Rrogat e përfaqësuesve dhe zyrtarëve të jashtëm dhe zyrtarëve të punësuar vendor të Kombeve të Bashkuara dhe të agjencive të saj të specializuara dhe Agjencia Ndërkombëtare për Energji Atomike.
- Rrogat e personelit të jashtëm të KFOR-it dhe EULEX-it;
- Të ardhurat nga poliset e sigurimit të jetës që paguhen si rezultat i vdekjes së personit të siguruar;
- Të ardhurat e kontraktuesit primar ose nënkontraktuesit, përveç personave vendor, që janë krijuar nga kontratat me qeveritë e huaja, organet e tyre dhe Agjencitë, Bashkimin Evropian, etj.
- Pagat e personave me nevoja të veçanta, siç parashihet me ligjet përkatëse për këto kategori;
- Pagesat e pensioneve dhe asistencat sociale të paguara nga Qeveria e Kosovës;
- Asetet e marra apo vlera e aseteve të marra si rezultat i trashëgimisë;
- Shpenzimet edukative / arsimore të paguara nga një punëdhënës në interes të një të punësuarit;
- Bursat e marra nga një individ për të marrë pjesë në një institucion për mësim të lartë, shkollë zanati, apo shkollë profesionale, përderisa bursa është paguar drejtpërdrejtë në institucion;
- Shpenzimet për ndjekje të programit të trajnimit të paguara nga një punëdhënës për një të punësuar për të marrë pjesë në programet zyrtare të trajnimit për të marrë shkathtësitë që lidhen me punën;
- Përfitimet për dëmshpërblime të marra nëpërmjet vendimeve të formës së prerë të gjykatave si dhe kompensimet e caktuara për kostot gjyqësore;
- Të ardhurat në formë shpërblimi nga institucionet shtetërore për arritje në shkencë, sport dhe kulturë;
- Të ardhurat e përfituara nga grantet, subvencionet dhe donacionet, në harmoni me rregullat dhe kushtet e përfitimit të tyre;
- Dividenda e pranuar nga personi rezident dhe jorezident;

• Të ardhurat bruto nga paga

Në të ardhurat bruto nga paga përfshihen:

- Rrogat e paguara në emër të një punëdhënësi për punën të cilën e kryen punonjësi sipas udhëheqjes së drejtorit ose punëdhënësit,
- Bonuset, provizionet, mëditjet dhe forma tjera të kompensimit që një punëdhënës apo ndonjë person tjetër,
- në emër të punëdhënësit ua paguan punonjësve mbi pagën,

- Të ardhurat e fituara nga puna e përkohshme të cilën e kryen punonjësi,
- Të ardhurat nga punësimi i mundshëm, siç është nënshkrimi i një bonusi të rrogës,
- Premitë e sigurimit të jetës që një punëdhënës paguan për punonjësin,
- Falja e huas së punonjësit ose e obligimit të punëdhënësit,
- Pagesa e shpenzimeve personale të punonjësit nga punëdhënësi, dhe
- Përfitimet në gjësende që një punëdhënës ia jep punonjësit, që kalon shumën minimale të përcaktuara me një akt nënligjor të lëshuar nga Ministri i Financave.

Në të ardhurat e përgjithshme nga rrogat nuk përfshihen:

- Kompensimi i shpenzimeve reale të udhëtimeve të biznesit deri në shumën e përcaktuar me akt nënligjor nga Ministri,
- Dëmshpërblimi për aksidentet në punë,
- Përfitimet në natyrë në formë të shujtave dhe transportit të ofruara nga punëdhënësi për punëtorin duke përjashtuar kompensimin në para, etj.

Tatimpaguesit që pranojnë apo që realizojnë të ardhura prej vetëm një burimi si paga e cila ka qenë subjekt i mbajtjes në burim, nuk janë të detyruar të dorëzojnë deklaratë tatimore vjetore.

• Të ardhurat nga paga e dytë

Punëdhënësi i cili nuk është punëdhënës kryesor i të punësuarit, mbanë në burim shumën prej dhjetë përqind (10%) të pagave të tatueshme për periudhën tatimore.

• Mbajtja e tatimit në burim në paga dhe pensione

Secili punëdhënës është përgjegjës për mbajtjen në burim të tatimit në të ardhurat e tatueshme nga pagat e punonjësve të tij gjatë çdo periudhe të pagesës së pagave.

Punëdhënësi i cili është punëdhënës kryesor i të punësuarit, mban në burim një shumë të tatimit për periudhën përkatëse të pagesave të pagave, në përputhje me normat si në vijim:

Norma tatimore	Të ardhurat mujore
0%	0 deri 80
4%	80 deri 250
8%	250 deri 450
10%	450 e tutje

Punëdhënësi kryesor dhe ai sekondar kontribuon me pesë përqind (5%) mbi pagën bruto të të punësuarit në emër të kontributit pensional.

Punëdhënësi zbrit pesë përqind (5%) nga paga bruto e të punësuarit, dhe i paguan në emër të kontributit pensional.

Secili punëdhënës, apo person që kërkohet të mbajë në burim tatimin në paga dhe kontributet pensionale, dorëzon pasqyrën e tatimit dhe kontributit pensional të mbajtur në burim dhe e transferon shumën e tatimit dhe kontributit personal të mbajtur në burim në llogarinë e caktuar nga ATK-ja në një bankë, apo institucion financiar, i licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas ditës së fundit të secilit muaj kalendarik.

• **Tatimi i mbajtur në burim në interes, të drejta pronësore, qira, kategori të veçanta dhe jo-rezidentë.**

Tatimi i mbajtur në burim në interes, të drejta pronësore, qira, kategori të veçanta dhe për jo-rezidentë aplikohet njësoj sikurse është sqaruar në pjesën e mësipërme tek Tatimi në të Ardhura të Korporatave.

• **Deklarata e tatimit**

Tatimpaguesi, nga i cili kërkohet apo ai i cili zgjedh t'i nënshtrohet tatuarjes në bazë të të ardhurave reale, është i obliguar të përgatis dhe deklaroj të ardhurat, duke përshtatur për qëllime tatimore, të ardhurat dhe shpenzimet e raportuara.

• **Pagesat e tatimit nga veprimtaritë afariste**

Tatimpaguesi me të ardhura bruto vjetore deri në pesëdhjetëmijë euro (50,000€) i cili nuk kërkohet ose nuk ka zgjedhur për tatuarje në baza reale, bën pagesat për tremujor, si në vijim:

- Tre përqind (3%) të të ardhurave bruto të pranuar nga tregtia, transporti, bujqësia dhe veprimtaritë e ngjashme komerciale të çdo tremujori, por jo më pak se 37.5€ për tremujor;
- Nëntë përqind (9%) të të ardhurave bruto të pranuar, nga shërbimet, veprimtaritë profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme të çdo tremujori, por jo më pak se 37.5€ për tremujor;

Tatimpaguesi i cili nuk ka të ardhura në një periudhë tremujore, nuk kërkohet pagesë, por tatimpaguesi është i obliguar të dorëzojë formularin me obligim pagese zero.

Tatimpaguesit me të ardhura vjetore bruto mbi pesëdhjetëmijë euro (50,000€) dhe ata që zgjedhin vullnetarisht të taten në bazë të të ardhurave reale, janë të obliguar të bëjnë pagesa paradhënie tremujore për Tatimin në të Ardhura Personale, si në vijim:

- Një të katërtën (1/4) e detyrimit të përgjithshëm tatimor për periudhën tatimore në vijim, bazuar në të ardhurën e tatueshme të vlerësuar dhe të zvogëluar nga cilado shumë e mbajtur në burim gjatë tremujorit që lidhen me ato të ardhura, në përputhje me legjislacionin përkatës për Tatimin në të Ardhurat Personale, apo për periudhën

e dytë dhe periodat vijuese tatimore për të cilat tatimpaguesi bënë pagesën sipas këtij paragrafi, së paku një të katërtën (1/4) e njëqindëdhjetë përqind (110%) të detyrimit të përgjithshëm tatimor të periudhës paraprake për periudhën aktuale të zvogëluar nga cilado shumë e mbajtur në burim gjatë tremujorit që lidhen me ato të ardhura, në përputhje me legjislacionin përkatës për Tatimin në të Ardhura Personale.

Tatimpaguesi i cili bën pagesën tremujore paradhënie, obligohet të bëjë një deklaratë vjetore me rregullime përfundimtare të tatimeve dhe paguan shumën e duhur deri më 31 mars të vitit pas periudhës tatimore.

• **Pagesat për të ardhurat nga qiratë**

Tatimpaguesi, i cili merr të ardhura nga qiraja, përveç atyre tatimpaguesve aktiviteti afarist i të cilëve është dhënia me qira e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, paguan çdo tremujor në vit, dhjetë për qind (10%) të të ardhurave të tatueshme të marra nga qiraja (të ardhurat bruto nga qiraja minus dhjetë për qind (10%) zbritje të paraparë). Pagesa bëhet në llogarinë e caktuar nga ATK në një bankë apo institucion financiar të licencuar nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik.

III. **TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR**

Që nga shtatori i vitit 2015, TVSH është përshkallëzuar në dy norma, atë standarde prej tetëmbëdhjetë për qind (18%) dhe normën e reduktuar prej 8% të vlerës së furnizimeve të importuara dhe furnizimeve të brendshme të tatueshme, me përjashtim të furnizimeve të liruara dhe furnizimeve të trajtuara si eksporte.

Norma e reduktuar e TVSH-së llogaritet dhe paguhet prej tetë për qind (8%) për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, si dhe importin e tyre, si në vijim:

- Furnizimi me ujë, përveç ujit të ambalazhuar;
- Furnizimi me energji elektrike, përfshirë shërbimet e transmisionit dhe distribuimit, me ngrohje qendrore, mbledhjen e hedhurinave dhe trajtimin e mbeturinave tjera;
- Drithërat sikurse janë elbi, misri, varietetet e misrit, tërshëra, thekra, orizi dhe gruri;
- Prodhimet e bëra prej drithërave për qëllim të konsumimit njerëzor, sikurse janë mielli, brumërat, buka dhe prodhime të ngjashme;
- Vajrat për gatim të bërë nga drithërat apo farërat vajore për përdorim në gatim për konsumim njerëzor;
- Qumështi dhe produktet e qumështit me qëllim për konsumim njerëzor;
- Kripa e përshtatshme për konsum njerëzor;
- Vezët për konsum;
- Librat shkollore dhe publikimet serike;

- Furnizimi duke përfshirë huadhënien e librave nga bibliotekat, përfshirë broshurat, fletëpalosjet dhe materialet e ngjashme të shtypura, librat me fotografi për fëmijë, librat për vizatim dhe ngjyrosje, librat e muzikës në formë të shtypur apo të dorëshkrimit, hartat dhe grafiqet hidrografike dhe të ngjashme;
- Pajisjet e teknologjisë së informacionit;
- Furnizimi i barnave, produkteve farmaceutike, institucioneve dhe aparateve mjekësore dhe kirurgjike.
- Pajisjet mjekësore, autoambulancat, ndihmat dhe aparatet tjera mjekësore me qëllim që të lehtësojnë ose trajtojnë paaftësinë për shfrytëzim ekskluziv të të paaftëve, duke përfshirë riparimin e këtyre mallrave dhe furnizimin e ulëseve të fëmijëve për vetura;

• Objekti i tatuarjes

Një transaksion është objekt i tatuarjes për TVSH në Kosovë, nëse është furnizim malli ose furnizim shërbimi, i kryer kundrejt pagesës, brenda territorit të Kosovës, nga një person i tatueshëm që vepron si i tillë. Gjithashtu, importi i mallrave sipas kuptimit të Ligjit është objekt i tatuarjes për TVSH.

• Person i tatueshëm

Person i tatueshëm është çdo person qoftë ky individ, person fizik ose juridik, ose i organizuar në çdo formë tjetër të njohur nga legjislacioni në Kosovë, i cili në mënyrë të pavarur kryen veprimtari ekonomike sipas kuptimit të Ligjit, pavarësisht vendit, qëllimit, ose rezultatit të kësaj veprimtarie. Për TVSH nuk është i rëndësishëm rezultati (humbje/fitim) i veprimtarisë ekonomike.

• Regjistrimi për TVSH

Çdo person që i përmbush të gjitha kushtet e përkufizimit mbi personin e tatueshëm, kërkohet që të regjistrohet për TVSH, nëse brenda vitit kalendarik tejkalon qarkullimin prej tridhjetëmijë euro (30.000€). Vetëm pjesa e furnizimit e cila rezulton në tejkullimin e qarkullimit, do të merret parasysh për qëllime të TVSH-së.

• Ç regjistrimi për TVSH

Çdo person i tatueshëm i regjistruar në TVSH në mënyrë të detyrueshme apo vullnetare, mund të kërkojë nga ATK që të çregjistrohet për qëllime të TVSH-së, nëse gjatë vitit të fundit kalendarik, qarkullimi i tij ka rënë nën pragun e paraparë me nenin 6 paragrafi 1 i Ligjit. Çregjistrimi hyn në fuqi dy (2) muaj pas datës së paraqitjes së kërkesës, nëse aprovet nga ATK.

• Funksionimi i TVSH-së

Në përputhje me parimet e BE-së dhe të TVSH-së, eksportet janë të liruara nga TVSH me të drejtën e TVSH-së së zbritshme.

TVSH-ja në importe mblihet në kufijtë shtetëror të Kosovës. Bartësi i transaksionit paguan TVSH-në në bazë të vlerës doganore dhe në çdo tatim tjetër të importit (taksa doganore dhe akciza, nëse janë të aplikueshme) pavarësisht origjinës së tyre.

TVSH-ja aplikohet në importe dhe në çdo furnizim të mallrave dhe shërbimeve, me përjashtim të atyre të cilat sipas ligjit konsiderohen si furnizime të liruara.

Sipas Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH, disa furnizime janë të liruara nga TVSH me të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshme dhe disa furnizime janë të liruara nga TVSH pa të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshme.

• Lindja e detyrimit për të ngarkuar TVSH

Momenti i lindjes së detyrimit për të ngarkuar TVSH-në është momenti kur ndodh furnizimi i mallit apo shërbimit. TVSH bëhet e ngarkueshme varësisht se cili nga tre momentet ndodh e para:

- Furnizim i mallit apo shërbimit,
- Lëshimi i faturës në lidhje me furnizimin e mallit apo shërbimit, ose
- Pranimi i pagesës në avancë/paradhënie, para se të ketë ndodh furnizimi i mallit apo shërbimit.

• Shuma e tatueshme

Shuma e tatueshme e furnizimit të mallrave ose furnizimit të shërbimeve, përbëhet nga të gjitha shumatat, vlerat, pagesat, mallrat apo shërbimet e pranuar apo që do të pranohen nga furnizuesi i mallit/furnizuesi i shërbimit si kundërvlerë e këtyre furnizimeve, kundrejt blerësit, klientit apo një të treti, përfshirë dhe subvencionet që lidhen drejtpërdrejtë me çmimin e këtyre furnizimeve. Pra, Shuma e tatueshme e një furnizimi të tatueshëm në Kosovë në lidhje me furnizimin e mallrave dhe shërbimeve përfshin çdo gjë që përbën konsideratën e marr ose që do të merret nga furnizuesi që është paraparë për atë furnizim.

• Lirimet në importim

Gjatë importimit, TVSH nuk paguhet për:

- Mallrat e importuara me qëllim të shfrytëzimit zyrtar nga zyrat diplomatike dhe konsullore, dhe misionet speciale të akredituara në Kosovë;
- Mallrat e importuara me qëllim të shfrytëzimit zyrtar nga organizatat ndërkombëtare, nëse këto janë parashtruar në traktatet apo marrëveshjet ndërkombëtare të cilat zbatohen në Kosovë;
- Mallrat e importuara me qëllim të shfrytëzimit personal nga personeli i huaj i misioneve speciale diplomatike dhe konsullore të akredituara në Kosovë, duke përfshirë këtu edhe anëtarët e tyre të familjes;
- Mallrat e importuara për forcat e Armatosura të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior dhe KFOR-it;

- Arin, metalet tjera të çmueshme, bankënotat dhe monedhat metalike të importuara nga Banka Qendrore e Kosovës;
- Importin e gazit përmes sistemeve të distribuimit të gazit natyror ose importi i energjisë elektrike;
- Linjat e prodhimit dhe makineritë për përdorim në procesin e prodhimit,
- Lëndën e parë që shfrytëzohet për procesin e prodhimit;
- Pajisjet e teknologjisë së informacionit;
- Gazetat dhe botimet periodike;
- Pajisjet dhe materialet e importuara për nevojat e mediave të shkruara dhe elektronike.
- Importin e mallrave të listuara në Shtojcën IV të Ligjit për TVSH.

• **Furnizime të liruara nga TVSH me të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshme, janë:**

- Eksportet,
 - Furnizimi i mallrave dhe shërbimeve në lidhje me transportimin ndërkombëtar,
 - Furnizimi i mallrave ose shërbimeve nën aranzhimin diplomatik dhe konsullor,
 - Furnizimi i mallrave ose shërbimeve për organet ndërkombëtare dhe ndër-qeveritare të njohura si të tilla nga autoritetet publike të Kosovës,
 - Furnizimi i mallrave apo shërbimeve për NATO-n dhe KFOR-in ,
 - Furnizimi i arit për Bankën Qendrore,
 - Ujitja e tokave bujqësore,
 - Furnizimi i mallrave dhe shërbimeve të financuara nga të ardhurat e donacioneve;
- Furnizimi i mallrave dhe shërbimeve të bëra për Kombet e Bashkuara ose ndonjë nga agjencitë e saj, Banka Botërore dhe organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare;
- Furnizimi i mallrave dhe shërbimeve publike të bëra për Bashkësitë fetare të Kosovës;
 - Transporti ajror dhe hekurudhor ndërkombëtar i pasagjerëve dhe transporti i mallrave të tyre shoqëruese, etj.

• **Furnizime të liruara nga TVSH-ja pa të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshme, janë:**

- Furnizimi i shërbimeve spitalore dhe kujdesi mjekësor;
- Furnizimi i shërbimeve të edukimit;
- Furnizimi i shërbimeve të mirëqenies dhe sigurimit social;

- Furnizimi i gazetave dhe botimeve periodike, si dhe furnizimi i
- shërbimeve nga mediat elektronike të radios dhe televizionit;
- Furnizimi i shërbimeve të transportit publik të udhëtarëve dhe bagazhit të tyre;
- Furnizimi i shërbimeve të sigurimit dhe risigurimit të jetës dhe shëndetit;
- Furnizimi i shërbimeve financiare;
- Furnizimi në vlerën nominale të pullave fiskale, pullave postale dhe pullave të tjera të ngjashme;
- Furnizimi i basteve, lotarive dhe lojërave të tjera të fatit;
- Furnizimi i tokës, tokës në të cilën qëndron ndërtesa apo shtëpia;
- Furnizimi i shtëpive, banesave ose të ngjashme, që do të shfrytëzohen për qëllime relevante të banimit duke përfshirë garazhet dhe bodrumet, etj.

• **Aplikimi i normës së sheshtë të TVSH-së për prodhuesit bujqësor**

Norma e sheshtë për prodhuesit bujqësor është 8 %. Përlllogaritja për prodhuesit bujqësor bëhet nga blerësi - person i tatueshëm, kundrejt furnizimeve të kryera të mallrave.

Norma e sheshtë konsiderohet brenda çmimit të përlllogaritur të blerjes së mallrave.

Skema e normës së sheshtë zbatohet mbi produktet si në vijim:

- Produkte primare bujqësore të përgjithshme;
- Bimët zbukuroese, aromatike, mjekuese, të natyrës dhe të serave;
- Prodhimi i kërpudhave dhe frutave të malit;
- Prodhimi i fidanëve (kultivimi i pemëve dhe perimeve të reja për shitje) dhe farërave.
- Qumësht dhe nën-produkte të qumështit;

IV. SHMANGIA E TATIMIT TË DYFISHTË

Kosova për momentin ka Marrëveshje për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë me Republikën Maqedonisë, Turqinë Britaninë e Madhe, Slloveninë, Hungarinë, Belgjikën, Finlandën, Shqipërinë, Gjermaninë dhe Holandën, Republikën e Letonisë dhe Republikën e Lituaniës.

Marrëveshjet për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë me shumë shtete tjera janë në proces të bisedimeve.

IV. DETYRIMET DOGANORE

Taksa doganore është 0% - 10%

Shumica e lëndëve të para janë të liruara,

Shumica e pajisjeve për prodhimin janë të liruara me Ligjin Nr. 04/L-163.

Disa nga materialet e papërpunuara bujqësore (të tilla si farat, etj.) dhe pajisjet janë të liruara nga Dogana dhe TVSH-ja.

Janë bërë lirimet edhe me zgjerimin e aneksit të Ligjit Nr. 04/L-163 publikuar me 16.01.2014

Udhëzimin Administrativ 05/2015 te datës 30.09.2015 shtohet

aneksi 1 ku behet lirimi i barnave kreut te 30 si dhe Gazi natyral dhe LPG për energji.

Udhëzimin Administrativ 07/2016 te datës 12.10.2016 shtohet

Lista e mallrave me tatim zero e cila i shtohet Aneksit 1, Pjesa

B dhe Pjesa D të Ligjit ku lirohen mallrat; Koks nafte i kalcinuar, Vajrat si lëndë djegëse, si dhe Vajrat lubrifikante.

AKCIZA

Akcizat aplikohen në disa mallra vendore ose të importuara të tilla si: cigare, pije alkoolike, ujë dhe pije të tjera freskuese, naftë, etj.

Kodi tarifor	Karburantet	
2711	Gazet e naftës dhe hidrokarbure tjera azotike	€0.15/l
2707	Vajrat dhe prodhimet e tjera të distilimit të katranit të thëngjillit në temperatura të larta	€0.325/l
2710 11 (nr. i ri 2710 12) dhe 2710 19	Vajrat e petroleumit dhe vajrat e përfituara nga mineralet bituminoze (përpos naftës së papërpunuar)	€0.325/l
2710 1931 deri 2710 1949 (nr. i ri 27101948)	Vajra të gazit (naftë)	€0.36/l
2710196410 dhe 2710196490	Vajra të rënda për ngrohje	€0.25/l
3604	Fishekzjarrët	€2/kg
27101131 (nr. i ri 27101231) deri 27101190 (nr. i ri 27101290)	Alkooli për motorë	€0.385/l
2901, 2902	Hidrokarbure ciklike dhe aciklike	€0.36/l
3811	Të tjera të cilat përdoren për qëllime të njëjta si vajrat minerale	€0.36/l
3814	Tretësit kompozite organik dhe holluesit	€0.36/l
3817	Alkilbenzenët dhe alkilnaftalenët e përzier	€0.36/l
Norma e tatimit të Akcizës për Lojërat e Fatit	Në bazë të vendimit të Qeverisë 04/39	

Kalendari i Akcizave në Duhan, Kodi doganor 240220			
01 Shtator 2020	€/48 njësi konvencionale		
01 Janar 2021	€/49 njësi konvencionale		
01 Janar 2022	€/51 njësi konvencionale		
01 Janar 2023	€/53 njësi konvencionale		
01 Janar 2024	€/55 njësi konvencionale		
Ujërat, duke përfshirë ujërat minerale dhe të ajrizuara të cilat përmbajnë sheqer të shtuar apo ndonjë material tjetër ëmbëltuese apo që janë me shije, si dhe pijet e tjera joalkoolike, duke mos përfshirë lëngjet e frutave apo të perimeve nga kaptina 2009, me shifër 2202, ku tarifa e taksës reduktohet në zero pikë zero zero pesë euro për një litër (0.005€/ltr) Vendimi Nr.09/12; Datë 09.07.2020			
Pijet Alkoolike			
Birra	€800/ hl		
Vlera	€500/ hl		
Veturat			
Përdorimi (vite)	Deri 2000cc (€)	2001-3000cc (€)	mbi 3001cc (€)
	0	0	300
8	400	400	1000
9	600	600	1500
10	700	800	1800
11	800	1000	2100
12	900	1200	2400
13	1000	1400	2700
14	1100	1600	3000
15	1200	1800	3300
16	1300	2000	3600
17	1500	2200	3900
Vendimi Nr. 09/12; Datë: 09.07.2020 Veturat Hibride me kode tarifore; 870340, 87035000, 870360 dhe 8703700 Tarifën e taksës e kanë 10 €			
Goma të përdorura	€5/ copë		
Poça elektrik	€0.3/ copë		
Qese plastike	€3/ kg		

Kontakt:

Ministria e Financave
 Departamenti i Politikave
 Fiskale dhe Tregjeve Financiare
 Divizioni i Politikave Fiskale
 Tel: +381 38 200 34 ext. 013
 E-mail: politikatfiskale.mf@rks-gov.net